



## KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

### VENDIM

Nr. 127, dt. 25.05.2016

Në mbështetje të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 25.05.2016, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë dhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

### VENDOSI:

1. Heqjen e pjeshme të statusit monument kulture kategoria II-të të fasadave lindore, jugore dhe veriore të stadiumit kombëtar “Qemal Stafa” në sheshin Nënë Tereza. Lënien në fuqi të statusit monument kulture kategoria II për fasadën kryesore (perëndimore) të stadiumit kombëtar “Qemal Stafa” në sheshin Nënë Tereza.
2. Miratimin e projekt –idesë së Kompleksit të ri të Stadiumit Kombëtar “Qemal Stafa”, me këto propozime:
  - Fasada kryesore (perëndimore) të dalë në plan të parë në anën e sheshit Italia
  - Eliminimin e propozimit të projektit në pjesën e kollonadave mes Rektoratit dhe Insitutit të Arkeologjisë
  - sjelljen e një varianti për trajtimin e sheshit Italia me materiale jo kontrastuese me materialet ekzistuese të Ansambllit në sheshin Nënë Tereza.
3. Miratimin e konceptit të restaurimit të fasadës kryesore (perëndimore) të stadiumit kombëtar “Qemal Stafa”.  
Miratohet plani i prishjeve të fasadave lindore, jugore dhe veriore të stadiumit kombëtar “Qemal Stafa” në sheshin Nënë Tereza.
4. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI

KRYETAR  
MIRELA KUMBARO TURXHI

